

**Këshilli i Sigurimit**Distr.: I përgjithshëm
5 tetor 2023

Origjinal: Anglisht

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**Raport i Sekretarit të Përgjithshëm****I. Hyrje dhe prioritetet e misionit**

1. Ky raport parashtrohet në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit [1244 \(1999\)](#), përmes së cilës Këshilli themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm që të raportoj në intervale të rregullta për zbatimin e mandatit të tij. Në këtë raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to nga data 19 mars deri më 18 shtator 2023.

2. Prioritetet e Misionit mbasin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në regjion. Në arritjen e objektivave të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin e konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me palët regjionale e ato ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë të kryejnë rolet e tyre brenda kornizës së Rezolutës [1244 \(1999\)](#). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit vazhdon praninë e tij në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 ([S/PRST/2008/44](#)) dhe me raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, të datës 24 nëntor 2008 ([S/2008/692](#)). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara bashkëpunojnë nga afër me Misionin.

II. Zhvillimet kryesore politike dhe sigurisë

3. Gjashtë muajt e kaluar janë shënuar me mospajtime të vazhdueshme mes Beogradit dhe Prishtinës, posaçërisht lidhur me legjitimitetin e kryetarëve shqiptarë të komunave në katër komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe. Gjendja e sigurisë në terren ka vazhduar të përkeqësohet si rezultat i provokimeve dhe retorikës së shtuar të palëve që kanë çuar në trazira të dhunshme, ku pjesëtarët e KFOR-it, si dhe qytetarët e gazetarët pësuan lëndime. Faktorët që kontribuan në tensionimin e gjendjes ishin si në vijim: protestat në veri të Kosovës; arrestimet e serbëve të Kosovës; paraburgimi i tre policëve të Kosovës nga ana e autoriteteve serbe; ardhja në veri të Kosovës e policëve të tjerë të njësisë speciale të Kosovës; shpronësimet e tokave dhe incidentet e shumta të sigurisë.

4. Si hap tjetër në zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë, të datës 27 shkurt, dhe të shtojcës së saj për zbatim, të datës 18 mars, më 18 prill u themelua një Komision i përbashkët monitorues. Komisioni udhëhiqet përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës dhe për çështjet e tjera regjionale të Ballkanit Perëndimor, ku janë edhe përfaqësuesi i Kosovës në Bruksel dhe kryenegociatori i Serbisë. Komisioni ende nuk është takuar.

23-18754 (E) 171023

2318754

Please recycle 



5. Më 2 maj, përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për punë të jashtme dhe politika të sigurisë lehtësoi takimin në Bruksel mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për të sqaruar zbatimin e hapave të marrëveshjes. Palët miratuan Deklaratën për persona të zhdukur, ku njihet çështja e personave të zhdukur si çështje humanitare, dhe theksuan nevojën urgjente për përpjekje të shtuara të përbashkëta në zbutjen e vuajtjeve të familjeve.

6. Në mbledhjen e datës 2 maj, është prezentuar draftstatuti për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe nga ana e Ekipit menaxhues për themelimin e bashkësisë së komunave serbe, i krijuar në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013. Ekipi menaxhues përbëhet nga përfaqësuesit e secilës nga katër komunat e veriut të Kosovës. Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian më tej ka theksuar pikëpamjet e ndryshme të palëve lidhur me natyrën e Asociacionit/Bashkësisë. z. Kurti më vonë tha se drafti i paraqitur nga Ekipi menaxhues nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Më 3 maj, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal deklaroi se kishte shpërbërë Ekipin menaxhues. Zëdhënësi i Shërbimit Evropian për Punë të Jashtme, u përgjigj duke thënë se Ekipi duhet të jetë në

funksion deri në miratimin e statutit dhe se rçfarëdo vendimi rreth Ekipit menaxhues duhet të miratohet brenda kornizës së dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

7. Një bllokim u krijua lidhur me renditjen e modaliteteve të zbatimit të Marrëveshjes dhe të shtojcës së saj për zbatim. Derisa Beogradi ngulmonte që hapat konkretë drejt themelimit të Asociacionit/Bashkësisë duhej të merreshim me prioritet, Prishtina nga ana tjetër thoshte se asnjë nen i Marrëveshjes nuk mund të jetë parakusht për zbatimin e neneve të tjera dhe se nenet duheshin të avancoheshin në mënyrë “të pavarur”. Takimet dypalëshe të mbajtura në Bruksel më 15 maj mes përfaqësuesit special të Bashkimit Evropian dhe kryenegociatorëve të Beogradit dhe Prishtinës gjithashtu nuk rezultoi në marrëveshje për hapat e ardhshëm.

8. Më 19 korrik, kryenegociatorët udhëtuan në Bruksel për takime të ndara dypalëshe me përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian. Në këto takime nuk u arrit ndonjë marrëveshje për mënyrën e ecjes përpara.

9. Më 14 shtator, përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian ndërmjetësoi takimin e nivelit të lartë në Bruksel mes z. Kurti dhe z. Vuçiq. Palët nuk u pajtuan rreth modaliteteve të renditjes për zbatimin e marrëveshjes apo për deeskalimin e tensioneve në veri të Kosovës. Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian më tej vuri në pah se qorrsoakaku do të ndikojnë në aspiratat e palëve për t’iu afruar Bashkimit Evropian.

10. Në ndërkohë, zhvillimet në veri të Kosovës ndikuan në procesin e dialogut. Këto zhvillime filluan me zgjedhjet për kryetarë komunash të datës 23 prill në të katër komunat e veriut dhe zgjedhjet për kuvendet komunale të Leposaviqit dhe Zveçanit për të zëvendësuar kryetarët e komunave dhe asambleistët që kishin dhënë dorëheqje në nëntor të vitit 2022. Zgjedhjet u zhvilluan në mënyrë paqësore, por u bojkotuan nga shumica e serbëve për herë të parë që nga Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013. Para zgjedhjeve, Lista Serbe ritheksoi kushtet e saj për pjesëmarrje, gjegjësisht themelimin e Asociacionit/Bashkësisë dhe tërheqjen e njësive speciale të policisë së Kosovës nga veriu i Kosovës. Sipas Komisionit Qendror Zgjedhor, në të katër komunat e veriut janë regjistruar 1,567 vota, që paraqesin 3,47 për qind të 45,158 votuesve të regjistruar. Kandidatët e partisë Lëvizja Vetëvendosje fituan zgjedhjet për kryetarë të komunave në Leposaviq dhe Mitrovicë të Veriut, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës fitoi në komunën e Zveçanit dhe të Zubin Potokut.

11. Më 24 prill, zëdhënësi i Shërbimit për Punë të jashtme të Evropës lëshoi një deklaratë, ku vihet në pah se zgjedhjet janë mbajtur në përputhje me kornizën juridike të Kosovës, por theksoi se rezultatet nuk ofronin zgjidhje afatgjatë politike. I njëjti qëndrim u shpreh nga përfaqësuesit e shteteve të kuintit (Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar e

Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës) më 18 maj, në një deklaratë të përbashkët.

12. Më 26 maj, policia e Kosovës përcolli kryetarët e sapozgjedhur të komunave në objektet komunale të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, gjë që çoi në trazira me protestuesit serbë, të cilët vunë në pikëpyetje legjitimitetin e kryetarëve të komunave. Më pas, z. Vuçiq urdhëroi ushtrinë e Serbisë që të rrisë nivelin e gatishmërisë luftarake në shkallën më të lartë. Më 29 maj, jashtë objektit komunal të Zveçanit, një grup i demonstruesve serbë u kacafyten me pjesëtarët e KFOR-it, të cilët ishin vendosur në mes për t'i ndarë protestuesit nga policia e Kosovës që gjendeshin para objektit. Sipas sekretarit të përgjithshëm të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), në sulmet në veri të Kosovës janë lënduar 93 pjesëtarë të KFOR-it, ku disa prej tyre kanë pësuar lëndime serioze. Përafërsisht 50 protestues gjithashtu kanë raportuar lëndime, duke përfshirë një plagosje me armë zjarri. Z. Vuçiq raportohet se ka kërkuar tërheqjen e menjëhershme të kryetarëve të komunave nga objektet komunale dhe tërheqjen e njësisve speciale të policisë së Kosovës, ndërsa z. Kurti më 1 qershor theksoi rëndësinë e punës së kryetarëve të komunave nga zyrat e tyre përkatëse komunale.

13. Palët ndërkombëtare njëzëri kanë dënuar incidentet, të cilat rezultuan me lëndime të rënda të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të qytetarëve. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë apeloi për udhëheqësi dhe veprime të përgjegjshme, si dhe për zvogëlimin e tensioneve dhe për ecje drejt zgjidhjeve të qëndrueshme politike. Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian nxiti autoritetet e Kosovës dhe protestuesit që menjëherë dhe pa kushte të deeskaloj gjendjen. Më 30 maj, NATO shpalli dërgimin e një batalioni shtesë prej 700 pjesëtarësh në Kosovë dhe vendosjen e batalionit shumëkombësh në forcave rezerve në nivel më të lartë gatishmërie.

14. Më 14 qershor, përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian iu përgjigj letrës së z. Kurtit të datës 12 qershor, ku ai sugjeronte hapat për deeskalim në veri të Kosovës. Përfaqësuesi i lartë theksoi në letrën e tij pritjet e Bashkimit Evropian lidhur me hapat e nevojshëm për kthimin e qetësisë. Ai nënvizoi deklaratën e Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 3 qershor, ku kërkohet tërheqja e njësisve për operacione speciale të policisë së Kosovës nga afërsia me objektet komunale, rregullimet për kryetarët e sapozgjedhur të komunave që përkohësisht të punojnë nga vendet alternative dhe shpalljen e zgjedhjeve të hershme për kryetarë komunash. Ai ngriti çështjen e pritjeve që serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhje, e cila gjithashtu iu ka bartur z. Vuçiqit. Në letër, përfaqësuesi i lartë theksoi se nëse nuk bëhet deeskalimi do të ketë pasoja negative”.

15. Shtetet e Bashkuara ftuan qeverinë e Kosovës që të përmbahet nga hapat e njëanshëm, dhe më 30 maj shpallen një numër masash, duke përfshirë

edhe mospërfshirjen e Kosovës në “Defender Europe 23” – stërvitjen shumëkombëshe vjetore ushtarake të komandës evropiane të Shteteve të Bashkuara me aleatët dhe partnerët e NATO-s.

16. Më 28 qershor, Bashkimi Evropian filloj një numër masash kundër qeverisë së Kosovës, me ç’rast ka theksuar se kërkesat e tij për hapa deeskalues kanë hasur në vesh të shurdhër, duke nënvizuar se masat ishin të përkohshme dhe të kthyeshme, dhe të varura nga vendimet e veprimet e qeverisë së Kosovës. Këto masa përfshijnë si në vijim: pezullimin e përkohshëm të punës së organeve brenda Marrëveshjes së stabilizim asocimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës; mospërfshirjen e Kosovës në takimet e nivelit të lartë, përveç në ato të fokusuara në trajtimin e krizës në veri të Kosovës brenda kornizës së dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian; ndalesën e përkohshme të programimit të fondeve për Kosovën nga Instrumenti i asistencës së paraaderimit për vitin 2024; dhe nuk do të ketë shqyrtim të propozimeve brenda Kornizës së investimeve në Ballkanin Perëndimor. z. Kurti tha se masat ishin të padrejta. Në ndërkohë udhëheqësit e opozitës së Kosovës kanë shprehur mospajtimin në rritje me veprimet e z. Kurtit.

17. Sesioni pranveror i Kuvendi të Kosovës është karakterizuar nga polarizimi i rritur politik dhe vështirësitë në krijimin e forumit. Deputetët serbë të Kuvendit kanë bojkotuar Kuvendin që nga nëntori i vitit 2022. Deputetët e partisë opozitare Lidhjes Demokratike të Kosovës filluan bojkotimin e sesioneve në korrik të vitit 2023, duke theksuar mospajtimin e tyre me menaxhimin e krizës në veri të Kosovës nga ana e qeverisë së Kosovës.

18. Më 4 korrik, Bashkimi Evropian shpalli qëllimin e tij për të monitoruar respektimin nga ana e Serbisë të kërkesës për shtensionim dhe për marrjen parasysh të masave të mëtejshme. Në gusht, 10 kryesues të komisioneve për punë të jashtme dhe 56 ligjvënës të Evropës dhe të Shteteve të Bashkuara adresuan letrën përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian, sekretarit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara dhe sekretarit për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, duke kërkuar një qasje më të rreptë ndaj Beogradit dhe kthimin ekuilibrit dhe proporcionalitetit në trajtimin e Kosovës dhe Serbisë. Zëdhënësi i Shërbimit për Punë të Jashtme të Evropës ritheksoi neutralitetin e Bashkimit Evropian në procesin e dialogut, duke theksuar se shtetet anëtare janë konsultuar për veprimet e Bashkimit Evropian dhe se Bashkimi Evropian ishte në bashkërendim të ngushtë me partnerët, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

19. Më 29 qershor, qeveria e Kosovës shpalli dy grupe joformale të serbëve, gjegjësisht Civilna Zastita (Mbrotja Civile) dhe Brigada Sever (Brigada e Veriut) si organizata terroriste, duke thënë se ato paraqisin kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për rendin kushtetues dhe sigurinë në

Kosovë. Qeveria në mes të tjerash pretendonte përfshirjen e këtyre grupeve në sulmet kundër policisë së Kosovës, pjesëtarëve të KFOR-it dhe gazetarëve. Ky vendim ngriti shqetësime në mesin e banorëve të veriut të Kosovës, të cilët frikoheshin nga arrestimet e mundshme për lidhjet e perceptuara me këto grupe. Shtetet e Bashkuara kanë kritikuar qeverinë e Kosovës për dështim në bashkërendimin e vendimeve me partnerët ndërkombëtarë dhe ftuan qeverinë e Kosovës që të përmbahet nga hapat e njëanshëm. Ngjashëm me këtë, Bashkimi Evropian përshkroi këtë shpallje si hap i njëanshëm që nuk kontribuonte në shtensionimin e gjendjes në veri të Kosovës.

20. Më 2 qershor, z. Kurti shpalli në Kuvend të Kosovës emrat e serbëve të Kosovës, duke përfshirë anëtarët e Listës Serbe, të cilët pretendohet se kanë qenë organizatorët e protestave të dhunshme në veri të Kosovës. Lista Serbe i mohoj këto pretendime.

21. Autoritete e Kosovës rekrutuan 74 policë (56 meshkuj dhe 18 femra) nga komunitetet joshumicë (46 serbë; 17 boshnjakë; 4 egjiptas; 3 turq; 2 romë dhe 2 ashkali) për të plotësuar vendet e lëshuara pas dorëheqjeve të serbëve në nëntor 2022. Më 24 korrik, 74 zyrtarët policorë filluan punën në veri të Kosovës. Raportohet se disa rekrutë të ri serbë janë kërcënuar, ku emrat dhe fotografitë e tyre janë publikuar në media sociale. Tre nga këta policë serbë kanë dhënë dorëheqje më 17 gusht. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, deklaroi se dorëheqjet kanë ardhur si rezultat i kërcënimeve dhe ngacmimeve nga Serbia, duke shtuar se Kosova do të vazhdoj të siguroj përfshirje në të gjitha institucionet. Raportohet se që atëherë gjithsej 11 policë të ri serbë kanë dhënë dorëheqje. Bashkimi Evropian dhe palët e tjera ndërkombëtare kanë shprehur shqetësimin për këto dorëheqje, duke theksuar nevojën që policët e Kosovës të punojnë pa pasur frikë nga ngacmimet dhe rëndësinë e një policie të larmishme dhe shumetnike.

22. Më 10 korrik në Bratisllavë, zëvendëskryeministri i Kosovës dhe kryenegociatori u pajtua me z. Lajčák lidhur me hapat e parë për shtensionim, të cilët më 13 korrik rezultuan me zvogëlimin e numrit të policëve të njësisë speciale afër objekteve komunale për 25 për qind. Zvogëlimi tjetër për 25 për qind është bërë më 3 gusht, me ç'rast policët janë dërguar në lokacionet e tjera në veri. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) deklaroi se ishte pajtuar me policinë e Kosovës që dy herë në javë të realizojnë vlerësime të përbashkëta të sigurisë, ndërsa me KFOR-in, sipas nevojës. z. Lajčák mirëpriti vlerësimin e parë të tillë më 3 gusht, duke thënë se ky ishte hap i rëndësishëm drejt shtensionimit të plotë në veri të Kosovës. Qeveria e Kosovës kërkoi heqjen e masave të Bashkimit Evropian kundër Kosovës pas zvogëlimin të numrit të pjesëtarëve të njësisë speciale të policisë së Kosovës. Bashkimi Evropian vuri në pah se nevojiteshin hapa të tjerë për plotësimin e kushteve të cekura në deklaratën e tij të 3 qershorit për Kosovën.

23. Pas incidenteve të sigurisë në maj, palët regjionale morën rol më aktiv dhe kërkuan tejkalimin e qorrsokakut politik. Më 6 qershor, kryesuesi i organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë, paraqiti planin nëntëpikësh për shtensionim. Më 9 qershor, kryeministri i Shqipërisë ua dorëzoi udhëheqësve të Francës dhe Gjermanisë një draftstatut për Asociacionin/Bashkësinë dhe propozoi që Bashkimi Evropian të jetë nikoqir i një konference ndërkombëtare për marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës me pjesëmarrjen e të dyja palëve.

24. Përpjekjet e tjera diplomatike u përqendruan në mbajtjen e zgjedhjeve të reja dhe përfshirëse për kryetarët e komunave në veri të Kosovës. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës theksuan se dorëheqja e kryetarëve të komunave do të ishte hapi më pragmatik drejt nxitjes së zgjedhjeve të reja. Qeveria e Kosovës deklaroi se në vend të kësaj do të duhej të mbahej një referendum i bazuar në peticion në veri të Kosovës për të kërkuar zëvendësimin e kryetarëve të komunave. Më 5 shtator, Grupi punues i formuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nxori një udhëzim administrativ ku rregullohet procedura për tërheqjen e kryetarëve të komunave. Në udhëzim administrativ qartësohet procesi se si votuesit e regjistruar në secilën komunë mund të fillojnë procesin e tërheqjes, duke paraparë prapagun prej 20 për qind për iniciimin e referendumit.

25. Më 22 gusht, autoritetet komunale të Mitrovicës së Veriut nxorën një vendim ku kërkohet nga institucionet e financuara nga Serbia të lirojnë objektin komunal që gjendet në Mëhallën e Boshnjakëve në Mitrovicë të Veriut, duke thënë se institucionet nuk kanë dhënë dokumentacion për të arsyetuar shfrytëzimin e hapësirave të saj. Komuna ka vazhduar afatin për lirim të objekteve në pritje të raportit nga inspektorati komunal ku identifikohen rrethanat dhe arsyet për shfrytëzimin e hapësirave, i cili afat përfundon më 23 shtator. Zëdhënësi i Shërbimit të Punëve të Jashtme të Evropës ka shprehur shqetësimin për ndikimin e vendimit në gjendjen e sigurisë.

26. Pas takimit më 7 shtator në Bruksel me znj. Osmani, sekretari i përgjithshëm i NATO-s deklaroi se në përputhje me zotimin e Prishtinës të vitit 2013, çfarëdo dërgimi i Forcës së Sigurisë të Kosovës në veri të Kosovës kërkon pajtimin e KFOR-it. NATO gjithashtu pret konsultime me kohë dhe domethënëse për çfarëdo veprimi të Forcës së Sigurisë të Kosovës apo të Policisë së Kosovës që do të mund të ndikonte në mjedisin e sigurisë.

III. Veriu i Kosovës

27. Gjatë periudhës raportuese gjendja e sigurisë në veriun e Kosovës ka mbetur e brishtë. Më 10 prill, në punktin kontrollues të policisë së Kosovës te ura e Bistricës, një serb i Kosovës është plagosur nga arma e zjarrit nga pjesëtari i njësisë speciale të policisë së Kosovës. Pasi që fillimisht mohoj përfshirjen e policëve të saj, policia e Kosovës më vonë e ndryshoi rrëfimin e saj për incidentin dhe arrestoi katër policë shqiptarë të Kosovës. Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë dënoi incidentin dhe theksoi se një hetim i hollësishëm ishte thelbësor për drejtësinë, llogaridhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Më 12 prill, disa qindra protestues u grumbulluan afër punktit kontrollues te ura për të kërkuar tërheqjen e njësisë speciale të policisë së Kosovës nga veriu i Kosovës.

28. Më 10 maj, qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për shpronësimin e më shumë tokave në komunat Leposaviq dhe Zubin Potok për projekte të interesit publik. Ky vendim ka të bëjë me 118 parcela dhe me përafërsisht 137 hektarë të tokës private, në pronësi kryesisht të serbëve. Pas dëgjimeve publike për shpronësim, të mbajtura në shkurt 2023, titullarët e pronave shprehën shqetësimin për transparencën, të drejtat pronësore dhe qasjen në mjete ligjore, duke parashtruar ankesa para Gjykatës themelore në Mitrovicë, të cilat presin zgjidhje.

29. Zyrat e UNMIK-ut që gjenden në hapësirat komunale të Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit janë thyer gjatë incidenteve të majit. Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë i tha autoriteteve të Kosovës se asetet dhe hapësirat e Kombeve të Bashkuara janë të pacenueshme dhe kërkoj qasje në hapësira, duke thënë se liria e lëvizjes e personelit të Kombeve të Bashkuara duhet të mbrohet dhe të garantohet gjithmonë. UNMIK-u, me përkrahjen e KFOR-it dhe në bashkërendim me policinë e Kosovës ka rimarrë disa nga asetet e veta dhe ka siguruar zyrat. UNMIK-u nuk ka pasur mundësi të rifillojë punën në këto hapësira.

30. Më 1 qershor, përafërsisht 100 individë u grumbulluan për të protestuar në jug të lumit Ibër në Mitrovicë të Jugut nën moton “Të marshojmë në veri” për të shprehur mbështetjen për z. Kurtin. Ditën e njëjtë, dy shqiptarë që mbanin emblema të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u sulmuan në Mitrovicë të Veriut, me ç’rast morën lëndime të lehta. Më 7 qershor, raportohet se në Zveçan u dëmtuan dy automjete që u përkisnin shqiptarëve.

31. Më 13 qershor, policia e Kosovës arrestoi një serb në Mitrovicë të Veriut, i cili akuzohej për orkestrimin e incidenteve të 29 majit. Ditën vijuese, disa qindra qytetarë protestuan në Mitrovicë të Veriut, duke kërkuar

lirimin e individit të arrestuar. Në javët pasuese, policia e Kosovës arrestoi disa serbë në veri të Kosovës nën pretendime për nxitje të dhunës ndaj KFOR-it dhe gazetarëve. Një videoincizim ku shihej keqtrajtimi dhe degradimi i njërit prej individëve të arrestuar derisa ishte në mbajtje në polici, është shpërndarë gjerësisht në media. Më 20 qershor, zyrtari ndërlidhës i Beogradit vizitoi gjashtë serbët që gjendeshin në mbajtje në komunën e Podujevës dhe atë të Gjilanit, dhe raportoi pretendimet për keqtrajtim nga policia, duke përfshirë përdorimin e tepërt të forcës dhe vendosjen në qeli.

32. Në periudhën prej 26 majit deri më 16 qershor, janë raportuar rreth 30 pretendime për sulme ndaj gazetarëve dhe anëtarëve të mediave e pronave të tyre në veriun e Kosovës. Bashkimi Evropian, KFOR-i dhe anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare dënuan dhunën kundër gazetarëve. Pronat komunale dhe automjetet e policisë së Kosovës janë sulmuar disa herë në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok gjatë periudhës së njëjtë.

33. Më 14 qershor, policia e Kosovës raporti se tre policë të patrullës së policisë së Kosovës ishin kidnapuar nga policia e Serbisë, derisa qeveria e Serbisë deklaroi se ata ishin arrestuar pas kalimit të kufirit administrativ. Pas shqyrtimit, KFOR-i deklaroi se vendi i saktë i policëve në momentin e arrestimit mbetet i paqartë dhe përkujtoi të dyja palët për përgjegjësitë e tyre lidhur me bashkërendimin me KFOR-in. Më 26 qershor, autoritetet serbe liruan me kusht tre policët e arrestuar, ku ndaj tyre është ngritur akuza për "prodhimin, mbajtjen dhe shitjen e armëve dhe materialit eksploziv".

34. Më 23 qershor policia e Kosovës deklaroi se gjatë inspektimit të automjetit me targa serbe në Zveçan, një sasi mjaft e madhe e armëve dhe pajisjeve ushtarake është konfiskuar.

IV. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut

Sundimi i ligjit

35. Më 23 mars, Këshilli Prokurorial i Kosovës në raportin e tij vjetor vuri në pah se në vitin 2022 Zyra e Prokurorit kishte pranuar 50,998 ankesa penale, ku veprimet janë ndërmarrë për 44,287 (87 për qind) që paraqet një përparim mjaft të madh. Megjithatë, në raport theksohet ritmi i ngadaltë në ngritjen e aktakuzave, lidhur edhe me konfiskimin e aseteve.

36. Më 24 mars, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nxjerri vendimin që Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i miratuar në dhjetor 2022, ishte jokushtetues dhe e bëri atë të pavlefshëm. Më 31 korrik, pas shqyrtimeve Ligji iu dorëzua për herë të tretë Komisionit të Venedikut për shqyrtim.

37. Më 7 prill, Institucioni i Avokatit të Popullit e dërgoi Ligjin për pagat në sektorin publik (që hyri në fuqi në shkurt 2023) në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, ku kërkohej një vlerësim pas ankesave për zvogëlimin e pagave dhe ndikimin e Ligjit në pavarësinë e gjyqësorit.

38. Më 2 maj, Zyra e Prokurorit Special e Kosovës për herë të parë ngriti një aktakuzë për një rast të krimeve të luftës kundër një serbi të Kosovës, i cili pritet të gjykohet në mungesë.

39. Më 21 qershor, një serb i Kosovës është arrestuar në komunën e Graçanicës lidhur me pretendimin për krime të luftës kundër popullatës civile gjatë luftës në Kosovë. Gjykimi i tij pritet të fillojë. Ky arrestim nxiti protesta të serbëve, të cilët u grumbulluan para stacionit policor, duke kërkuar lirinë e tij.

40. Që nga dorëheqja e serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor 2022, as Këshilli Gjyqësor i Kosovës e as Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk kanë vendosur për pranimin e dorëheqjeve të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

41. Më 23 mars, Këshilli Gjyqësor i Kosovës deklaroi qëllimin e tij për të vazhduar me seancat disiplinore kundër disa gjyqtarëve serbë që kishin dhënë dorëheqje. Më 28 korrik, Këshilli i rekomandoi znj. Osmani që ajo të shkarkoj dy gjyqtarë serbë me pretendimin se janë angazhuar në aktivitete politike gjatë punës së tyre si gjyqtarë, duke iu referuar pjesëmarrjes së tyre në protesta më 5 nëntor 2022, kur Lista Serbe njoftoi për dorëheqjen e serbëve nga institucionet e Kosovës.

42. UNMIK-u vazhdoi me ofrimin e shërbimeve për certifikimin e dokumenteve. Misioni përpunoi 1712 dokumente, ku nga këto 699 kishin të bënin me pensionet, 1013 me diploma universitare dhe certifikata martesore, të lindjes dhe të vdekjes. UNMIK-u asistoj në lëshimin e 44 fletarresteve dhe 12 kërkesave për ekstradim nga shtetet anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Policisë për Ndjekjen e Krimeve (INTERPOL) dërguar Kosovës. Gjithashtu u hapen 640 raste të reja në bazë të kërkesave për informacion. Gjithsej 974 raste lidhur me territorin vendbanimit të përhershëm për Kosovën ende mbesin të hapura.

Të drejtat e njeriut

43. Më 10 korrik, Kuvendi i Kosovës miratojë propozimligjin, përmes të cilit rregullohet procesi i aplikimit për statusin e të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me luftën, duke e zgjatur afatin e aplikimit deri më 15 maj 2025, me mundësi për një zgjatje tjetër të afatit edhe për dy vjet varësisht nga vendimi i qeverisë së Kosovës. Raportuesi special për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, dëmshpërblimeve dhe garancive për mospërseritje, si

dhe shoqërinë civile vendore, sugjeroj që për këtë qëllim të mos ketë fare afate.

44. Komisioni i qeverisë së Kosovës që është përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarit të dhunës seksuale të lidhur me luftën ia dha statusin e të mbijetuarit 1581 aplikuesve (1498 femra dhe 83 meshkuj), një rritje kjo nga numri prej 1450, sa ishte në mars të vitit 2023. Komisioni refuzoj 295 aplikacione (255 femra dhe 40 meshkuj). Më 12 dhe 26 korrik, Komisioni i Kuvendit të Kosovës për të drejta të njeriut, barazi gjinore, viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës, persona të zhdukur dhe peticione mbajti sesione të mbyllura për të diskutuar numrin e madh të aplikuesve të refuzuar.

45. Më 12 korrik, Gjykata Supreme e Kosovës liroi nga akuza ish-zyrtarin e Listës Serbe dhe ish-ministrin për Administrim të Pushtetit Lokal, Ivan Todosijević, i cili më parë ishte dënuar për nxitje të urrejtjes pas mohimit nga ana e tij të masakrës së vitit 1999 në fshatin Reçak në një fjalim të mbajtur në vitin 2019.

46. Më 13 korrik, Kuvendi i Kosovës shpalli Ligjin për Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë. Qeveria e Kosovës ka organizuar konsultime publike lidhur me draftstrategjinë për drejtësinë tranzicionale mes datës 15 maj dhe 2 qershor. UNMIK-u ka parashtruar komentet në draft, ku avokohej për një qasje në drejtësinë tranzicionale që në qendër do kishte viktimat dhe që ishte e bazuar në të drejta të njeriut.

47. Më 1 gusht, Gjykata Kushtetuese nxori vendimin se Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Vendimin që mund të hapë rrugën për përfshirjen e normave ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara brenda kornizës juridike të Kosovës, e ka mirëpritur edhe Përfaqësuesja ime Speciale. Ky veprim ka ardhur pas aktiviteteve të avokimit të aktivistëve për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, të mbështetura nga UNMIK-u. Disa elemente të tjera të legjislaturës për të drejtat e njeriut ende presin miratimin, duke përfshirë projektligjet për personat e zhdukur, për lirinë e fesë, për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna gjinore, si dhe projektligji civil.

48. Ende janë 1616 persona të zhdukur (262 femra dhe 1354 meshkuj) lidhur me ngjarjet e viteve 1998–1999 në Kosovë. Përderisa nuk ka pasur përparim në Grupin punues për persona të zhdukur në nivel të udhëheqësve të delegacioneve, nëngrupi punues për çështje të forensikës dhe ekipi për analiza në muajin mars mbajtën dy takime. Po ashtu është bërë një vlerësim i përbashkët dhe një inspektim i përbashkët në prill, përkatësisht në gusht. Komisionet e qeverisë së Kosovës, përmes nëngrupit punues, kanë vlerësuar

disa vende në Kosovë dhe i kanë shënuar disa prej tyre si vende të varrezave masive, ndërsa në Serbi nuk ka pasur vlerësime. Më 30 gusht, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë thirri palët që të zgjidhin fatin e personave të zhdukur në frymën e pajtimit, që të ndërtojnë besimin dhe respektin për të drejtat e njeriut dhe që të depolitizojnë procesin.

49. Rastet e fjalimeve të urrejtjes në baza etnike janë regjistruar në postimet e mediave, ku disa komente mund të llogariten edhe si nxitje. UNMIK-u ka vërejtur incidente të fjalimeve të urrejtjes që veçanërisht kishin cak gratë në politikë, duke përfshirë sulmet në media sociale kundër deputetes së Kuvendit të Kosovës, e cila ka përkrahur projektligjin për shëndetin riprodhues dhe plleshmërinë e asistuar mjekësore. Postimet e tjera kanë pasur cak komunitetin e personave lezbikë, homoseksual, biseksual, transgjjinor, queer dhe ndërseksual (LGBTQI+). Më 8 gusht janë gjetur grafitë homofobë në Universitetin e Prishtinës.

50. Sulmet fizike dhe verbale ndaj gazetarëve vazhduan të ngrisin shqetësime për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për siguri të personit. Rrjeti regional joqeveritar për Gazetarët e Sigurt dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës regjistruan më shumë se 40 sulme ndaj gazetarëve, duke përfshirë ata që mbulonin zhvillimet në veri të Kosovës.

51. Më 14 qershor, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve e Kosovës pezulloi certifikatën e punës së stacionit të madh medial të Klan Kosovës, në bazë të asaj se lokacioni i biznesit të këtij stacioni në mënyrë jokushtetuese referohet të jetë në Republikën e Serbisë. Më 28 korrik, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë njoftoi se Komisioni për shqyrtimin e ankesave për regjistrimin të bizneseve kishte refuzuar ankesën e Klan Kosovës kundër vendimit. Klan Kosova kishte parashtruar ankesën ku kërkohej urdhri i gjykatës komerciale dhe akuzoj qeverinë e Kosovës për mbylljen e gojës së mediave. Më 2 gusht, gjykata komerciale nxori vendimin për të shtyrë pezullimin deri dhënien e vendimit të formës së prerë. Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë kërkoj nga qeveria e Kosovës që ta gjejë një rrugë për t'u siguruar që Klan Kosova të mund të vazhdojë transmetimin dhe të ruajë tablonë e larmishme të mediave të Kosovës.

52. Më 8 gusht, Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në të njëjtat baza ua revokoi certifikatat e biznesit 15 subjekteve ekonomike që veprojnë në Kosovë. Këtu përfshihet Telefonia Mobile e Serbisë (MTS DOO), e cila është ofruesi kryesor i shërbimeve të telekomunikacionit, televizionit dhe të internetit për serbët në veri të Kosovës, si dhe për shumë të tjerë në jug të Kosovës. Më 30 gusht, MTS DOO parashtrroi një ankesë kundër këtij vendimi para Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

53. Numri i madh i të dyshuarve në paraburgim, duke përfshirë edhe disa të arrestuar së fundmi në veri të Kosovës, kanë ngritur shqetësime për të

drejtat e njeriut. Si rezultat i procedurave në përgjithësi të gjata gjyqësore për rastet penale në Kosovë, individët mbesin në paraburgim për periudha të gjata, që ka rezultuar me shtyrjen e gjykimeve të tyre. Sipas Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, vonesat në procedurat gjyqësore kanë qenë arsyeja më e shpeshtë e ankesave të pranuar nga Zyra. Serbët e Kosovës dhe qeveria e Serbisë kanë kërkuar nga gjykatat që të përdorin alternativat ndaj serbëve të paraburgosur në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

54. Avokati i Popullit i Kosovës thërret autoritetet që të zbatojnë të drejtën në mjet të efektshëm juridik për viktimat e shkeljes së të drejtës për gjykim.

V. Zhvillimet e tjera kryesore

55. Prej marsit deri në gusht, kanë ndodhur disa incidente në lokacionet fetare ortodokse serbe të komunitetit joshumicë. Si shembull janë incidentet e vjedhjeve nga Kisha Ortodokse Serbe, duke përfshirë nga vendet që konsiderohen si zonë e posaçme e mbrojtur sipas legjislacionit të Kosovës. Përveç kësaj, persona të panjohur tentuan ta djegin portën e kishës ortodokse serbe në Prizren. Ndër rastet e tjera është edhe përdhosja e faltores së improvizuar të Kishës Ortodokse Serbe në një vend me komunitete të përzier. Kjo faltore konsiderohet si simbol i tolerancës dhe i bashkëjetesës paqësore mes serbëve dhe shqiptarëve në atë zonë. Në disa vende të përkatësive të ndryshme fetare në mbarë Kosovën ka pasur vjedhje, ku komuniteti i prekur ka qenë shumica, duke përfshirë kisha ortodokse serbe dhe xhamia e varreza myslimane.

56. Si reagim ndaj arrestimit të policëve të Kosovës nga policia serbe, më 14 qershor qeveria e Kosovës ua ndaloi hyrjen të gjithë kamionëve që bartnin mallra të Serbisë apo që kishin targa të Serbisë. Derisa ndalesa për kamionët me targa të Serbisë më vonë u hoq, ndalesa e hyrjes në Kosovë të mallrave serbe ka mbetur në fuqi, duke prekur kështu, fjala bie, furnizimet mjekësore, siç tha drejtori i spitalit të Mitrovicës së Veriut.

57. Më 8 prill, policia e Kosovës lëshoi një udhëzim, përmes të cilit ndalohen të gjitha aktivitetet sportive e subjekteve sportive që nuk janë të regjistruara në federatën e sporteve të Kosovës.

58. Në maj, është arrestuar një shqiptar në Zveçan pas publikimit të videos në mediat sociale ku mbante një pushkë derisa po hiqte flamurin serb në fshatin Graboc. Më 30 maj, policia e Kosovës arrestoi tre meshkuj që

dyshohen për djegien e flamurit serb në Graçanicë. Të nesërmen flamurin e kanë ndërruar shërbimet komunale.

59. Vendimi i qeverisë së Kosovës i datës 28 tetor 2022, ku kërkohet regjistrimi i targave të automjeteve të lëshuara nga Serbia, ka vazhduar të tensionojë marrëdhëniet me komunitetin serb. Nga data 30 mars deri më 1 prill, tetë automjete të serbëve janë djegur në veri të Kosovës, duke përfshirë shtatë automjete që kishin vendosur targat e lëshuara nga Kosova. Më 1 prill është arrestuar një serb në Zubin Potok nën akuza për zjarrvënie.

60. Gjatë majit dhe qershorit, prona komunale dhe automjetet e policisë së Kosovës disa herë janë sulmuar në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok

61. Më 14 qershor, stafi mjekësor i qendrës shëndetësore në komunën e Shtërpçës, në jug të Kosovës, raportuan se janë shqetësuar nga patrulla e policisë së Kosovës, e cila kishte ndaluar dhe kontrolluar automjetin e emergjencës mjekësore që bartte një pacient afër Vushtrrisë.

62. Më 19 prill, Parlamenti Evropian ratifikoi liberalizimin e vizave për Kosovë që do t'ua mundëson mbajtësve të dokumentit të udhëtimit të Kosovës udhëtimin pa viza në vendet e Shengenit për 90 ditë dhe që do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar 2024. Më 20 qershor, Komiteti për çështje politike dhe demokraci në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës zgjodhi Theodora Bakoyannis si raportuese për anëtarësimin e Kosovës.

63. Më 8 qershor, Kuvendi i Kosovës miratoi në leximin e dytë Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Në Ligji të mbështetur nga Komisioni Qendror Zgjedhor janë përfshirë shumica e 23 rekomandimeve të raportit të Misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të Bashkimit Evropian.

64. Më 13 qershor, kryeministri i Shqipërisë anuloi takimin vjetor të përbashkët të qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës, që ishte i paraparë për datën 14 qershor, duke theksuar se takimi nuk do të mund të mbahej në rrethanat e marrëdhënieve të rënduara të Kosovës me tërë komunitetin euroatlantik. Më vonë dy qeveritë nënshkruan një numër marrëveshjes për bashkëpunim kulturor, ekonomik, arsimor, gjyqësor dhe të sigurisë mes Kosovës dhe Shqipërisë.

VI. Ndërtimi i besimit, partneriteti dhe bashkëpunimi

65. Nënsekretari i përgjithshëm për operacione paqësore morri pjesë në ngjarjen “Ndërtimi i besimit në Kosovë”, të organizuar nga UNMIK-u më 11 maj, e cila shënoi 5-vjetorin e përpjekjeve të Misionit për ndërtimin e

besimit dhe ku u mbledhën më shumë se 250 udhëheqës shoqëror nga të gjitha komunitetet, nga institucionet qendrore dhe ato lokale, shoqëria civile, rinia, ndikuesit e mediave dhe partnerët ndërkombëtarë. Kjo ngjarje ishte mundësi për njohjen e ndërtuesve të suksesshëm të besimit dhe ofroj mundësi për ndërveprim mes anëtarëve të komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Me këtë rast u shpërfaq nevoja për përkrahje dhe angazhim të vazhdueshëm në nivelin bazë me qëllim të kultivimit të kohezionit social dhe ndërtimit të besimit mes të gjitha komuniteteve në Kosovë.

66. Gjatë kësaj konference u bë njoftimi për themelimin e Qendrës Barabar, e cila do të drejtohet në Prishtinë nga Organizatat Joqeveritare (OJQ) nga Mitrovica e Veriut dhe Prishtina. Qendra që përkrahet nga UNMIK-u do të shërbejnë si pikë ndëretnike për aktivitetet e ndërtimit të besimit dhe si një hapësirë për ndërveprime profesionale, shoqërore dhe kulturore mes profesionistëve nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

67. Në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, UNMIK-u kontribui në përmirësimin e sistemit të arkivit të gjykatave të Kosovës, duke dhënë ndihmesë teknike dhe duke angazhuar 20 juristë praktikantë, të cilët arkivuan rastet në përputhje me kriteret e ligjit të Kosovës. Një vend për arkiv është krijuar në Gjykatën themelore të Mitrovicës. Përveç kësaj, në bashkëpunim me Akademinë për Drejtësi të Kosovës, janë trajnuar më shumë se 190 asistentë juridikë dhe zyrtarë juridikë nga fusha e të drejtës civile. Nga ana tjetër, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) vazhdoi me përkrahjen e Këshillit në modernizimin e sistemit të arkivit në gjykata, duke digjitalizuar përafërsisht 300,000 dosje të lëndëve në të gjitha shtatë gjykatat e instancës së parë.

68. UNMIK-u vazhdoi përkrahjen e Qendrës për Ndihmë Juridike të Institutit për Drejtësi të Kosovës, duke ofruar ndihmë juridike falas për 385 individë të cënueshëm (152 femra dhe 233 meshkuj) për çështjet lidhur me të drejtat pronësore, pensionet, dhunën në familje dhe marrëdhëniet e punës.

69. UNMIK-u përkrahu trajnimin e 12 juristëve të ri të komunitetit serb në veri të Kosovës dhe sponsorizuan 20 studentë të fakultetit juridik në vitin e fundit të studimeve që vinin nga të gjitha komunitetet. Trajnimi u zhvillua në klinikën juridike me temën shkathësitë e trajnimit dhe praktika juridike. Përmes përpjekjeve bashkëpunuese të UNMIK-ut dhe UNDP-së, është dhënë ndihmesa në përkthim për Gjykatën themelore në Prishtinë dhe atë në Mitrovicë përmes ekipit të 14 përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë. Rezultatet e kësaj përpjekjeje kanë përfshirë përkthimin e afro 300 lëndëve gjyqësore dhe interpretimi i më shumë se 200 seancave.

70. UNMIK-u vazhdoi me fuqizimin e hapësirës për shoqërinë civile, me monitorimin dhe raportimin e të drejtave të njeriut, si dhe të ofroj ndihmesë teknike institucioneve për të harmonizuar legjislacionin me normat dhe standardet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut. UNMIK-u

regjistroi më shumë se 40 përfaqësues komunalë, të ministrive dhe të shoqërisë civile në kursin për mosdiskriminim të platformës së re të profesionistëve juridikë për edukim nga fusha e të drejtave të njeriut. UNMIK-u promovoi të drejtat gjuhësore duke përkrahur mësimin e të dy gjuhëve zyrtare përmes një platforme në internet që jep trajnime falas të gjuhës serbe dhe shqipe. Me përkrahjen e UNMIK-ut, afro 40 organizata të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut publikuan raportin e tyre të katërt vjetor për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, i cili i është dorëzuar qeverisë më 17 maj.

71. Për të shënuar 75-vjetorin e Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut, UNMIK-u organizoj dy lexime publike të Deklaratës me të rinjtë, dedikojë një kabinë në konferencën e UNMIK-ut për ndërtimin e besimit të vitit 2023 dhe ua dërgoj kopjet e Deklaratës në gjuhët zyrtare të komuniteteve në 17 komuna.

72. UNMIK-u ndihmoj në ndërtimin lokal të besimit përmes arteve të komunitetit dhe proceseve të revitalizimit kulturor në Mitrovicë të Veriut dhe atë të Jugut përmes nismës artistike ndëretnike. Misioni ka vazhduar fuqizimin ekonomik të rinisë së komuniteteve rome, ashkallike dhe egjiptase në Mitrovicë përmes ngritjes së kapaciteteve. UNMIK-u gjithashtu mbështeti zhvillimin e raportit të analizës nga dy OJQ nga Prishtina dhe Mitrovica e Veriut, që fokusohet në reagimet institucionale ndaj incidenteve të sigurisë në komunitetet joshumicë. Në raport jepen rekomandime për vendimmarrje të bazuar në informata, zhvillim të politikave, llogaridhënie publike, përmirësim të besimit në institucione dhe fuqizim të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. UNMIK-u vazhdoi përkrahjen e projekteve për mbrojtje të mjedisit, duke u fokusuar në ndërgjegjësim dhe fuqizim të aktiviteteve mjedisore të rinisë. UNMIK-u gjithashtu ka përkrahur ndërtimin e strehimores që qëndrueshme nga aspekti mjedisor për viktimat e dhunës gjinore në Mitrovicë të Jugut.

73. Më 27 prill, Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit (UNODC) dhe OSBE përfunduan një trajnim në Pejë për luftën kundër financimit të terrorizimit. Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) u ndihmoj shtatë të kthyerve nga Republika Arabe e Sirisë dhe Iraku me grante fillestare dhe bursa, si dhe përkrahu bartjen e kompetencave nga autoritetet qendrore në ato lokale për menaxhimin e proceseve të reintegrimit.

74. Më 26 maj, UNDP dhe UNODC organizuan një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrjen e 30 zyrtarëve nga fusha e antikorrupsionit dhe anëtarë të shoqërisë civile nga Kosova dhe Shqipëria lidhur me rolin e edukimit kundër korrupsionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe shkëmbimin e praktikave të mira. UNDP-ja vazhdoi me ofrimin e përkrahjes në fushën e hartimit të legjislacionit kundër korrupsionit.

75. Më 9 qershor, UNMIK-u në partneritet me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS), fuqizuan kapacitetet digjitale të mjekësisë ligjore të Agjencisë për Forenzikë të Kosovës përmes ofrimit stacioneve të forensikës me teknologji të avancuar informative. UNMIK dhe UNOPS gjithashtu ndihmuan në përmirësimin e qasjes në drejtësi për të gjitha komunitetet në Shtërpecë përmes renovimit të degës së gjykatës, e cila u inaugurua më 15 qershor.

76. Shumë komuna ndanë fonde për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Romëve më 8 prill. Rreth 100 pjesëtarë të komunitetit rom nga Fushë Kosova morën pjesë në organizime të ndryshme në kuadër të nismës së financuar nga UNMIK-u që kishte për qëllim fuqizimin e përfshirjes sociale dhe të kulturës së komunitetit rom në Kosovë.

77. UNMIK-u, në partneritet me IOM, vazhdoi aktivitetet e tij në rritjen e bashkëpunimit institucional dhe avancimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Theksi është vënë në të drejtat gjuhësore përmes përkrahjes së autoriteteve qendrore, siç është Komisioneri për gjuhët dhe Avokati i Popullit. IOM ka mbështetur qeverinë e Kosovës në grumbullimin e të dhënave përmes internetit dhe në krijimin e një platforme të informatave, e cila do të mund të lehtësonte mundësitë për trajtimin e çështjeve lidhur me të drejtat e komuniteteve joshumicë.

78. Në mars, qeveria miratoi strategjinë e saj zhvillimore deri në vitin 2030 dhe miratoi planin trevjeçar zhvillimor që është në përputhje me Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, me përkrahje të ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

79. Qeveria e Kosovës njoftoi për shtyrjen e regjistrimit të popullsisë dhe të amvisërive nga data 1 shtator deri më 1 nëntor 2023.

VII. Gratë, paqja dhe siguria

80. Më 13 maj, me mbështetjen e UNMIK-ut, Këshilli për qeverisje gjithëpërfshirëse, një OJQ ndërkombëtare, mbështeti një takim në Prizren mbi integrimin e grave dhe agjendën e paqes dhe sigurisë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Politikanët pjesëmarrës dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia vunë në dukje mungesën e grave në dialogun e përkrahur nga Bashkimi Evropian, dhe rekomanduan përfshirjen sistematike të perspektivave gjinore dhe pjesëmarrjen kuptimplote të grave në këtë proces.

81. Më 30 maj, UNMIK-u dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN-Women), drejtoi Ditën e hapur globale të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë në Kosovë, të dhjetën me radhë, mbi fuqizimin ekonomik të grave. Kjo ngjarje prezantoi bizneset e udhëhequra nga gratë nga komunitete të ndryshme në Kosovë.

82. Më 4 gusht, Gjykata Themelore në Ferizaj nxori aktgjykim dënues kundër dy personave të akuzuar për vrasjen e një gruaje 18-vjeçare në vitin 2021. Një i pandehur u dënua me burgim të përjetshëm për vrasje, ndërsa i dyti u dënua me 15 vjet burg për ndihmë në kryerjen e vrasjes. Të dy të pandehurit u liruan nga akuzat për përdhunim. Ky vendim është vlerësuar nga qeveria e Kosovës dhe opinioni publik si një hap i rëndësishëm në luftën kundër femicideve.

83. Misioni ngriti vetëdijesimin për çështjen e martesave të fëmijëve, duke përfshirë shfaqjen e dy filmave të përgatitur nga UNMIK-u, "Romni" dhe "Si një grua e vërtetë", të cilët trajtojnë çështjen e martesave të hershme në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë.

84. UN-Women dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ndihmuan në luftimin e ngacmimit seksual në vendin e punës përmes aktiviteteve trajnuese që përfshinin më shumë se 200 zyrtarë, sipërmarrës dhe gazetarë.

85. Agjencia për barazi gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit udhëhoqi zbatimin e planit të veprimit të Kosovës për rezolutën 1325 (2000) të Këshillit të Sigurimit, duke promovuar qasjen në drejtësi, masat rehabilituese dhe fushatat ndërgjegjëse për të mbijetuarat e dhunës seksuale. UN-Women ofroi mbështetje teknike për integrimin gjinor në proceset e drejtësisë tranzicionale, duke u fokusuar te të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin.

86. UNMIK-u dhe ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë vazhduan të avancojnë agjendën për rininë, paqen dhe sigurinë përmes mbështetjes së grupit punues ndërministror të qeverisë së Kosovës, për strategjinë e re të Kosovës për rininë dhe hartimin e Ligjit për rininë, i cili përfshiu pjesëmarrjen e të rinjve joshumicë në procesin e hartimit.

87. Në prill, Misioni bashkëpunoi me një OJQ-në lokale për të ofruar trajnime për ngritjen e kapaciteteve për 50 anëtarë të këshillave rinore komunale (56 për qind gra), dhe mbështeti zhvillimin e planeve të veprimit për rininë në katër komuna shumetnike.

88. Në prill, projekti rajonal i fokusuar tek të rinjtë i mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për ndërtimin e paqes, i zbatuar nga UNDP, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, ndër të tjera, angazhoi grupe të ndryshme rinore në Kosovë për të promovuar mesazhe pozitive në media dhe për të identifikuar informatat e gabuara dhe informatat e rrejshme. Më 10

maj, projekti mundësoi pjesëmarrjen e më shumë se 60 të rinjve me aftësi të kufizuara në garat sportive.

89. Nga maji deri në qershor, UNMIK-u mbështeti trajnimin e 40 punëtorëve të rinj (55 për qind gra dhe 35 për qind nga komunitetet joshumicë), për luftimin e gjuhës së urrejtjes në internet, bullizmit kibernetik dhe diskriminimit.

90. Nga 6 deri më 8 qershor, UNMIK-u organizoi Asamblenë e pestë vjetore të rinisë së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, së bashku me agjencitë e Kombeve të Bashkuara, organizatat ndërkombëtare, institucionet e Kosovës dhe rrjetet rinore lokale dhe rajonale. Ngjarja mbledhi së bashku më shumë se 220 liderë të rinj nga Kosova dhe rajoni (57 për qind gra dhe 33 për qind nga komunitetet joshumicë), për diskutime mbi pjesëmarrjen e të rinjve në qeverisje, punën në komunitet, ndërtimin e paqes dhe organizatat ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara dhanë gjithashtu grante të vogla për gjashtë iniciativa të udhëhequra nga të rinjtë. Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë siguroi pjesëmarrjen e të rinjve me aftësi të kufizuara.

91. UNICEF-i vazhdoi të mbështesë programin Kosova Generation Unlimited, në partneritet me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Rrjetin kosovar të përgjegjësisë sociale të korporatës, i cili synon të promovojë punësimin dhe fuqizimin e të rinjve për 10,000 të rinj gjatë dy viteve të ardhshme, ku në shënjestër ka komunitetet joshumicë.

VIII. Kthimet, pajtimet, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet në komunitet

92. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) regjistroi 24 kthime vullnetare, 8 gra dhe 16 burra, nga komuniteti serb, të cilët ishin zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës. Kjo e çon numrin e përgjithshëm të personave të zhvendosur të komuniteteve joshumicë që kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000 në 29.321, në mesin e tyre 14.392 gra dhe 14.929 burra, të përbërë nga 12.762 serbë, 7.770 egjiptas dhe ashkali, 4.077 romë, 1.879 boshnjakë, 1.464 goranë, 1.325 shqiptarë, 21 malazezë, 19 turq dhe 4 kroatë. Akoma janë 15.646 persona të zhvendosur brenda Kosovës, 7.203 gra dhe 8.443 burra, si dhe 69.627 persona me nevoja të lidhura me zhvendosjen në të gjithë Ballkanin perëndimor, nga rreth 200.000 persona të zhvendosur nga Kosova që jetojnë në rajon, shumica e tyre në Serbi.

93. IOM kontribuoi në kushte të sigurt për kthime duke mundësuar jetesë të qëndrueshme dhe integrim të qëndrueshëm për të kthyerit, duke përfshirë ndërtimin ose rindërtimin e 15 shtëpive për 54 të kthyer (24 gra dhe 30

burra), 13 nga familjet ishin zhvendosur në Serbi, 1 në Mal të Zi dhe 1 brenda vendit.

94. Stacionet rajonale të policisë regjistruan 195 të ardhur emigrantë (184 burra dhe 11 gra), të cilët u akomoduan në qendrën e pritjes së përkohshme, e cila ofron shërbime të mbrojtjes me mbështetjen e IOM-it. Përveç kësaj, u identifikuan 77 emigrantë dhe azilkërkues të paregjistruar (66 burra dhe 11 gra), kryesisht nga Maroku, Republika Arabe Siriane, Somalia, Algjeria dhe territoret e pushtuara palestineze. Metodologjia e matricës së përcjelljes së zhvendosjes e zhvilluar nga IOM-i, i lejon qeverisë së Kosovës qasje në trendët gjithëpërfshirës të emigrimit. Një total prej 67 kërkesash për azil iu dorëzuan autoriteteve, 44 nga burra dhe 23 nga gratë, në lidhje me të cilat UNHCR-ja siguroi që të gjithë azilkërkuesit të merrnin ndihmë juridike falas, mbështetje psikosociale dhe shërbime përkthimi. IOM ndihmoi dy emigrantë që të ktheheshin në vendet e tyre të origjinës (Marok dhe Filipine).

95. UNHCR-ja ofroi ndihmë juridike për 49 individë (24 gra dhe 25 burra) të komunitetit ashkali, egjiptas dhe rom të Kosovës në lidhje me procedimin e regjistrimit të statusit të tyre civil dhe zgjidhjen e çështjeve të statusit civil. UNHCR vazhdoi të mbështesë anëtarët e komunitetit ashkali, egjiptas dhe rom të Kosovës në marrjen e dokumentacionit personal dhe zgjidhjen e çështjeve të statusit civil për të mundësuar qasjen e tyre në shërbimet publike.

96. Qeveria e Kosovës ka ndarë 3 milionë euro për të mbështetur mundësitë e punësimit për bizneset, prodhuesit e vegjël të bujqësisë në zonat rurale dhe organizatat e shoqërisë civile që kontribuojnë në integrimin e komuniteteve.

97. Më 3 korrik, Ministria për Komunitete dhe Kthim e Kosovës shpalli listën preliminare të përfituesve për një tender prej 2 milionë eurosh të ndarë për komunitetet joshumicë. Një milion euro iu ndanë 104 fermerëve nga komuniteti ashkali, boshnjak, egjiptas, serb dhe turk të Kosovës dhe 1 milion euro iu ndanë OJQ-ve.

98. Zyra për çështje të komuniteteve në zyrën e kryeministrit ka iniciuar një program për ndarjen e gjithsej 500,000 eurove në grante për komunitetet joshumicë, më 31 maj. OJQ-të dhe disa media të Kosovës pretenduan për mungesë drejtësie në procesin e ndarjes pasi vetëm 3 nga më shumë se 40 OJQ që përfaqësojnë komunitetet joshumicë u shpallën më 11 korrik si përfitues preliminar të granteve. Zëvendësi i Avokatit të Popullit të Kosovës shprehu shqetësimin për ndarjen e mjeteve dhe njoftoi se ka filluar një hetim. OJQ-të që përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës i kërkuar qeverisë të anulohet thirrjen për financimin e komunitetit.

99. Pas rikonstituimit të Komisionit të pavarur të qeverisë së Kosovës për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut në dhjetor 2022, ai mbajti 12 mbledhje dhe regjistroi 63 diploma për

verifikim. Verifikimi i diplomave do t'u mundësojë të diplomuarve të Universitetit të Mitrovicës së Veriut, kryesisht serbëve të Kosovës, qasje të barabartë në punësim në institucionet e Kosovës.

100. Vendimi i vitit 2016 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës mbi kërkesën për regjistrimin e tokës së manastirit ortodoks serb të Deçanit, ende nuk është zbatuar nga qeveria e Kosovës, pavarësisht thirrjeve të përsëritura nga anëtarët e komunitetit diplomatik, Bashkimit Evropian, OSBE-së, dhe UNMIK-ut. Më 20 maj, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën, përsëriti thirrjet drejtuar institucioneve të Kosovës që të mbështesin sundimin e ligjit dhe të zbatojnë vendimin e kahershëm.

101. Gjatë periudhës raportuese, nuk janë bërë kontribute të mëtjshme në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara në mbështetje të komunitetit ashkali, egjiptas dhe rom të Kosovës të prekur nga helmimi me plumb në Kosovë.

Vrojtimet

102. Dënoj në mënyrën më të ashpër sulmet kundër pranive ndërkombëtare në terren dhe përdorimin e dhunës në përgjithësi. U bëj thirrje të gjitha palëve të parandalojnë dhe të përmbahen nga ndërmarrja e veprimeve të njëanshme që mund të çojnë në tensione të shtuara dhe përshkallëzim të mëtjshëm.

103. Është shqetësues fakti se palët nuk kanë bërë përparim të dukshëm në zbatimin e Marrëveshjes në rrugën e normalizimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe se ende nuk kanë arritur marrëveshje për renditjen e dispozitave të aneksit të saj. Mungesa e progresit në dialog mbart rrezikun e tensioneve të mëtjshme dhe përshkallëzimit të mundshëm në terren. Unë u bëj thirrje palëve të riafirmojnë angazhimin e tyre të vërtetë ndaj dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian dhe të zbatojnë plotësisht të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani.

104. Është thelbësore të gjendet një zgjidhje për mbajtjen e menjëhershme të zgjedhjeve lokale të parakohshme dhe gjithëpërfshirëse në veri të Kosovës, me pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës, për të zbutur tensionet dhe për të ecur përpara.

105. Përshkallëzimi i tensioneve dhe incidentet e sigurisë në maj dhe qershor kanë ndikuar negativisht në procesin e dialogut. Është e domosdoshme që veprimet e liderëve politikë të udhëhiqen nga përkushtimi për të adresuar shqetësimet e të gjithë njerëzve të Kosovës. Dialogu mbetet rruga e vetme për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura.

106. Unë mirëpres Deklaratën për personat e zhdukur të miratuar nga Beogradi dhe Prishtina më 2 maj në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi

Evropian, dhe u bëj thirrje palëve të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të zbatuar dispozitat e saj në mirëbesim. Është thelbësore që çështja e personave të zhdukur të trajtohet me prioritet, e papolitizuar, për të lehtësuar vuajtjet e familjeve.

107. Inkurajoj të gjitha palët të zbatojnë masa që mbrojnë dhe promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut. Zbatimi i sundimit të ligjit, duke përfshirë edhe gjatë arrestimeve, akuzave, ndalimeve dhe veprimeve në lidhje me të drejtat pronësore, duhet të ushtrohet në përputhje të plotë me kornizën ligjore të Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

108. Rritja e tensioneve ka vazhduar të ndikojë në besimin edhe ashtu të brishtë ndërmjet komuniteteve dhe ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve, duke i bërë përpjekjet e ripërtëritura për ndërtimin e besimit dhe angazhimet ndërkombëtare një prioritet të vendosur të Misionit.

109. E përsëris apelin tim për kontribute vullnetare në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara për të rritur mbështetjen për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, të cilët mbeten ndër më të cenuarit në Kosovë.

110. Inkurajoj institucionet qeveritare, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare që të vazhdojnë të përmirësojnë kornizën ligjore dhe atë të politikave që trajtojnë dhunën me bazë gjinore, dhe të ndërmarrin hapa konkretë për të siguruar zbatimin efektiv të tyre. E mirëpres miratimin nga Kuvendi i Kosovës të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore.

111. E përsëris thirrjen time drejtuar qeverisë së Kosovës që të zbatojë vendimin e vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me pronën e manastirit të Deçanit. Kjo do të sinjalizonte një përkushtim të rëndësishëm të qeverisë së Kosovës për të mbështetur sundimin e ligjit dhe rendit kushtetues, dhe do të rriste besimin e qytetarëve në institucionet e saj.

112. Për të arritur marrëveshje të zbatueshme dhe të qëndrueshme, të dyja palët duhet të mbajnë një proces të hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës, që përfshin nevojat dhe pritshmëritë e ndryshme të të gjithë aktorëve të prekur, duke përfshirë gratë, të rinjtë dhe aktorët e shoqërisë civile. Unë përsëris thirrjen time për pjesëmarrje më të madhe dhe kuptimplote të grave përfaqësuese në dialogun e përkrahur nga Bashkimi Evropian.

113. Falënderoj Përfaqësuesen time Speciale, Caroline Ziadeh, për udhëheqjen e saj të Misionit dhe të gjithë stafin e UNMIK-ut për angazhimin dhe përpjekjet e tyre për të ndërtuar besim dhe për të inkurajuar një mjedis të favorshëm për dialog. Përcjell vlerësimin tim për partneritetin e fortë ndërmjet Misionit dhe ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, dhe mirëpres bashkëpunimin e ngushtë të vazhdueshëm me koordinatoren e Kombeve të Bashkuara për zhvillim në Kosovë. Për partnerët e vjetër të

Kombeve të Bashkuara në Kosovë, duke përfshirë Forcën e Kosovës (KFOR), Bashkimin Evropian dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, shpreh mirënjohjen time për përkushtimin e palëkundur për të garantuar paqen dhe sigurinë dhe për përmirësimin e jetesës së popullit të Kosovës.

Shtojca I Raporti i përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian për punë të jashtme dhe politika të sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga 18 marsi 2022 deri më 18 shtator 2023

Përmbledhje

Pas tërheqjes së serbëve nga institucionet e Kosovës, në katër komunitetë veriore të Kosovës janë organizuar zgjedhje të pjesshme lokale. Të planifikuara fillimisht për dhjetor 2022 dhe më pas të shtyra për 23 prill 2023, zgjedhjet për kryetar komune dhe ato të pjesshme komunale u mbajtën në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, dhe ishin bërë përpjekje që ato të zhvillohen në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Pjesëmarrja shumë e ulët (3.47 për qind e votuesve), për shkak të bojkotit nga komuniteti serb, tregoi se këto zgjedhje nuk ofruan një zgjidhje politike afatgjate për këto komuna. Vendimi i qeverisë së Kosovës për të vazhduar me vendosjen e kryetarëve të sapozgjedhur në ndërtesat komunale shkaktoi reagime të dhunshme në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, me ç'rast u lënduan dhe plagosen qytetarë, dhjetëra trupa të KFOR-it, forca të rendit dhe personel të mediave gjatë një proteste në Zveçan, më 29 maj. Përpjekjet diplomatike nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara ndihmuan në depërshkallëzimin e situatës. Megjithatë, tensionet vazhduan të jenë të larta, të përkeqësuar me arrestimin e disa serbëve nga Policia e Kosovës. Më 3 qershor, Bashkimi Evropian i bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë që të marrin masa të menjëhershme dhe të pakushtëzuara për të depërshkallëzuar situatën në veri të Kosovës.¹ Për të gjetur një rrugëdalje nga kriza aktuale, palët pritet të plotësojnë kërkesat e Bashkimit Evropian për depërshkallëzimin e situatës në terren, mundësimin e zgjedhjeve të reja lokale me pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve të Kosovës, kthimin në dialogun Beograd-Prishtinë dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi është pajtuar me Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčák, për hapat fillestarë për depërshkallëzimin e situatës, më 10 korrik në Bratisllavë, kur qeveria e Kosovës u zotua, ndër të tjera, për një reduktim të menjëhershëm me 25 për qind të pranisë së Policisë së Kosovës në dhe rreth ndërtesave komunale në veriun e Kosovës, dhe kryerjen e vlerësimeve të rregullta të përbashkëta të sigurisë me EULEX-in dhe KFOR-in, sipas nevojës. Takimi i parë u mbajt më 3 gusht dhe rezultoi me njoftimin e Policisë së Kosovës për një reduktim të mëtejshëm me 25 për qind të pranisë së saj në veri të Kosovës që nga 4

¹ www.Consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2023/06/03/statement-by-the-high-representative-on-behalf-of-the-eu-on-kosovo-and-latest-developments/.

gushti. Që atëherë kanë vazhduar takimet dyjavore, për të përcaktuar parimet dhe masat për këto vlerësime, të cilat kërkojnë shkëmbim gjithëpërfshirës të informacionit nga Policia e Kosovës. Dy nga kryetarët e sapozgjedhur janë duke punuar nga lokacione alternative.

Gjatë periudhës raportuese, Njësia e formuar e policisë së Misionit dhe njësia e policisë së formuar rezervë vazhduan të bashkëpunojnë ngushtë me KFOR-in dhe homologët e Kosovës. Këshilltarët e lartë policor të Misionit kanë monitoruar situatën në veri të Kosovës, duke mbajtur kontakte të ngushta me Policinë e Kosovës. Përderisa Misioni ruajti praninë dhe dukshmërinë e tij të shtuar në zonë, ai vazhdoi të kryejë detyrat e tjera operative, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit policor, mjekësisë ligjore dhe mbështetjes për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Njësia e monitorimit të rasteve të Misionit vazhdoi monitorimin e rasteve dhe gjykimeve të përzgjedhura, me fokus të veçantë në rastet që kanë të bëjnë me zhvillimet në veri të Kosovës, duke përfshirë arrestimet e bëra gjatë dhe pas përlëshjeve të dhunshme në fund të majit dhe në fillim të qershorit. Kjo njësi gjithashtu ka përcjellë incidentet potencialisht të motivuara etnikisht që prekin komunitetin serb të Kosovës gjetiu në Kosovë. Misioni publikoi raportin e tij të monitorimit, *Zbatimi i lirit me kusht në Kosovë*, dhe mbështeti autoritetet e Kosovës në zhvillimin e disa strategjive, duke përfshirë strategjinë për drejtësinë tranzicionale. Misioni gjithashtu organizoi dhe përkrahu seminare të shumta dhe aktivitete trajnimi në bashkëpunim me homologët e tij vendas.

Monitorimi

Tensionet që kishin zier për muaj të tërë shpërthyen në veri të Kosovës, pas zgjedhjeve të pjesshme lokale dhe përpjekjes në fund të majit nga qeveria e Kosovës për të vendosur kryetarët e sapozgjedhur shqiptarë në ndërtesat komunale të dikurshme serbe. Arrestimi i një prej krerëve të supozuar të mbrojtjes civile në mes të qershorit u pasua me thirrje për dhunë nga grupet militante, mirëpo, më 14 qershor, një marshim i madh protestues me rreth 1500 njerëz që kërkonin lirin e menjëhershëm të individit të lartpërmendur kaloi në mënyrë paqësore. Pak para arrestimit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, publikoi një propozim prej pesë pikash për de-përshkallëzimin e situatës, në të cilin ftoi Misionin që të monitorojë rastet gjyqësore që përfshijnë serbët nga veriu i Kosovës, duke mos i përmbushur kërkesat e parashtruara në deklaratën e 3 qershorit të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në emër të Bashkimit Evropian. Më 14 qershor, Policia e Kosovës pretendoi se tre oficerë të Policisë së Kosovës ishin “rrëmbyer” nga policia serbe pranë pikëkalimit të përbashkët në Rudnicë/Jarinjë (ata u liruan më 26 qershor), gjë që e tensionoi edhe më shumë situatën tashmë të tensionuar. Si hakmarrje e dukshme, qeveria e Kosovës e evidentoi mbrojtjen civile dhe një

nga komponentët e saj, Severna Brigada (Brigada e Veriut), si organizata terroriste.

Misioni monitoroi nga afër rastet penale që përfshinin serbët e Kosovës të dyshuar për përfshirje në ngjarjet e mësipërme. Për më tepër, Misioni vërejti se disa arrestime të serbëve të Kosovës u bënë jashtë situatave të flagrancës, pa filluar hetimi apo konsultimi i prokurorisë, në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në korrik, Misioni vërejti se Policia e Kosovës kishte paraqitur një kallëzim penal kundër 22 të dyshuarve në Prokurorinë Speciale të Kosovës, e cila më pas hapi një hetim, plotësisht në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Deri në fund të periudhës raportuese, disa persona vazhduan të mbaheshin në paraburgim në pritje të gjyqimit, ndërsa të tjerët u liruan me kusht.

Me qëllim të përcjelljes së pretendimeve për keqtrajtim policor, Misioni monitoroi hetimet nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe vizitoi disa të paraburgosur serbë të Kosovës të mbajtur në objektet korrektuese të Kosovës.

Misioni vazhdoi të monitorojë nga afër procedurat e shpronësimit të disa ngastrave të tokës nga qeveria e Kosovës në komunat Zubin Potok dhe Leposaviç në veri të Kosovës. Misioni ka vërejtur disa mangësi në zbatimin e legjislacionit përkatës nga institucionet e Kosovës.

Me ftesë nga homologët e tij kosovarë, Misioni mbështeti zhvillimin e disa strategjive, duke përfshirë rekrutimin, vlerësimin e performancës dhe procesin disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët dhe strategjinë kundër korrupsionit.

Misioni ka vërejtur një trend të vazhdueshëm të lirimeve dhe dënimeve të buta në rastet e profilin të lartë (duke përfshirë figura të njohura publike ose ish-raste të EULEX-it). Një shembull i kohëve të fundit ishte anulimi i seancave dëgjimore me një njoftim shumë të shkurtër, i cili pati të njëjtin efekt dëmtues në procedurat e gjyqimit si të ashtuquajturat seanca joproduktive.

Misioni gjithashtu monitoroi nga afër aktakuzat e para për krime lufte të ngritura në mungesë në Kosovë, për të vlerësuar nivelin e pajtueshmërisë nga institucionet gjyqësore me kërkesat ligjore për raste të tilla. Nga mesi i gushtit, kishte katër aktakuza të tilla, kurse asnjë gjyq nuk kishte filluar ende.

Në maj, Njësia korrektuese e Misionit publikoi raportin e saj, *Zbatimi i lirim me kusht në Kosovë*, në të cilin theksoi nevojën që autoritetet e Kosovës të sigurojnë zbatimin e duhur të lirim me kusht si një mjet efektiv për të parandaluar përsëritjen e shkeljes dhe për të promovuar zhvendosjen. Pas kërkesës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe si vazhdim i publikimit të raportit, Misioni ka nxjerrë listën e rekomandimeve për ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e panelit për lirim me kusht.

Misioni vazhdoi të mbështesë zhvillimin e mëtutjeshëm të ekipit të menaxhmentit të lartë profesional në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese, procesi i rekrutimit për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të shërbimit dështoi për të katërtën herë të jepte rezultate. Ekspertët e Misionit kanë ndihmuar gjithashtu Shërbimin Sprovues të Kosovës në hartimin e strategjisë organizative të Shërbimit. Gjatë gjithë periudhës raportuese, Misioni ka plotësuar përpjekjet e tij të rregullta monitoruese me projekte dhe aktivitete që synojnë nevojat specifike të homologëve të ndryshëm. Këto përfshijnë, ndër të tjera:

- Një kurs trajnimi dyditor për 45 avokatë për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën për liri dhe siguri dhe të drejtën për gjykim të drejtë, organizuar nga Misioni në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe Odën e Avokatëve të Kosovës.
- Prezantimi i raportit *Drejtësia në sytë e qytetarëve: Raporti i tretë për monitorimin e seancave gjyqësore nga qytetarët*, i ndihmuar nga Misioni me partnerin e tij zbatues, Institutin e Kosovës për Drejtësi. Në raport ata paraqesin gjetjet kryesore nga aktivitetet monitoruese për 600 gjykime penale të zhvilluara në mbarë Kosovën në janar dhe shkurt 2023 nga 20 vëzhgues porotë. Si pjesë e projektit, monitoruesit porotë janë trajnuar nga Instituti dhe EULEX-i për konceptet kyçe të procedurave gjyqësore dhe monitorimit të gjykimeve.
- Një seri sesionesh informative me anëtarët e familjeve të personave të zhdukur në pesë lokacione në mbarë Kosovën, në bashkëpunim me OJQ-në Qendra burimore e personave të zhdukur.
- Një punëtori dyditore mbi integrimin gjinor për 50 zyrtarë të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- Ofrimi i mbështetjes thelbësore për Shërbimin Sprovues të Kosovës në hartimin dhe zbatimin e një fushate digjitale për informimin e publikut për punën e Shërbimit, për masat dhe dënimet alternative që synojnë promovimin e procesit të rehabilitimit dhe risocializimit të personave të dënuar.
- Punëtori trajnuese me personelin e Policisë së Kosovës për përdorimin e dhomave të intervistimit në qendër të viktimave. Misioni kishte mbështetur KFOR-in dhe OSBE-në në ngritjen e shtatë dhomave të tilla në mbarë Kosovën, për t'u ofruar viktimave shërbimet e nevojshme në përputhje me Konventën e Stambollit.
- Një punëtori treditore për 25 drejtorë dhe këshilltarë për mbështetjen e kolegëve brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës.

- Sesione trajnuese për hetuesit e Policisë së Kosovës, mbrojtësit e viktimave, mjekët ligjorë, gjyqtarët dhe prokurorët për zbatimin e Protokollit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.
- Zbatimi i një projekti për promovimin e edukimit për të drejtat e njeriut në shkolla, në bashkëpunim me një OJQ lokale. Ai synonte 527 nxënës të shkollave fillore nga pesë komuna të Kosovës dhe mësuesit e tyre të edukatës qytetare.
- Punëtori për parandalimin e kontaminimit dhe kontaminimit të kryqëzuar të mostrave biologjike në vendin e punës. Punëtoritë u hartuan dhe u zhvilluan në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe kishin për cak 180 zyrtarë të Policisë së Kosovës dhe anëtarë të stafit të Institutit.

Operacionet

Në përgatitje për reagime të mundshme të dhunshme ndaj zbatimit të rezultateve zgjedhore në katër komunat në veri të Kosovës, Misioni avancoi qëndrimin e tij operativ, me vigjilencë të shtuar, patrullime për mbledhjen e informacionit dhe zbulimin, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in. Duke parashikuar një përshkallëzim të dhunës, Misioni konsolidoi dhomën e tij të operacioneve të krizave. Njësia e formuar policore e Misionit dhe Njësia policore e formuar rezervë vazhduan të patrullojnë në të gjithë Kosovën veriore, ndërsa këshilltarët e lartë policorë kanë koordinuar reagimin ndaj krizës në nivel operacional rajonal të Policisë së Kosovës. Gjatë gjithë periudhës raportuese, EULEX-i ka qenë i gatshëm të marrë rolin e tij si reagues i dytë i sigurisë, siç përcaktohet në strukturën e sigurisë së Kosovës, sipas së cilës Policia e Kosovës është e para, EULEX-i i dyti dhe KFOR-i reaguesi i tretë i sigurisë.

Në fund të majit, pas përleshjeve ndërmjet protestuesve dhe KFOR-it në veri të Kosovës, Misioni mbeti në gatishmëri të plotë me një zvogëlim të lehtë të patrullimit nga Njësia e formuar e policisë dhe Njësia e formuar policore rezervë, dhe me fokus të veçantë në monitorimin e sigurisë, situatës rreth ndërtesave komunale, pikëkalimeve të përbashkëta, pikave të kontrollit të Policisë së Kosovës, lagjeve të komuniteteve të përziera dhe objekteve të trashëgimisë kulturore. Misioni gjithashtu ka monitoruar veprimet e Policisë së Kosovës në veri të Kosovës. Njësia e formuar policore rezervë patrulloi vendbanimet serbe të Kosovës në jug të lumit Ibër.

Në fund të korrikut, 74 policë të sapotrajnuar nga komunitetet joshumicë (57 meshkuj dhe 17 femra), prej të cilëve 45 ishin serbë, filluan punën në veri të Kosovës. EULEX-i kishte mbështetur fushatën e rekrutimit të Policisë së Kosovës. Menjëherë pas vendosjes së tyre, rrjetet sociale, përfshirë Telegramin, publikuan mesazhe kërcënuese në gjuhën serbe drejtuar disa prej policëve serbë të Policisë së Kosovës. Institucionet e Kosovës dhe

bashkësia ndërkombëtare i dënuan këto kërcënime. Më 25 gusht, nëntë nga policët serbë të saporekrutuar kishin dhënë dorëheqje.

Misioni ka vazhduar të mbështesë Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Kjo përfshinte lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe byrove qendrore kombëtare të INTERPOL-it nën ombrellën e UNMIK-ut, si dhe shkëmbimin ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Evropiane për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (Europol) për hetimet e krimeve të rënda, përmes zyrës ndërlidhëse suedeze të Misionit Europol. Po ashtu, Misioni ka vazhduar të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe autoriteteve serbe, në përputhje me protokollin përkatës ndërmjet Misionit dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë, dhe ka shtuar përpjekjet e tij për të përmirësuar shpejtësinë dhe cilësinë e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë, përfshirë edhe rastet e ndjeshme.

Misioni vazhdoi të ofrojë mbështetje logjistike dhe operacionale për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me legjislacionin përkatës dhe mandatin e Misionit.

Ekipi i mjekësisë ligjore i Misionit ka mbështetur Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe Njësinë e Policisë së Kosovës për krime lufte në kryerjen e 12 operacioneve në terren. Nga këto, katër lokacione lidhen me hetimet në vazhdim në kërkimin e disa personave të zhdukur, të cilët akoma janë të pagjetur. Gjithsej, pesë grupe mbetjesh njerëzore u gjetën në varre të pashënuara në tri lokacione të ndryshme, duke përfshirë një grup mbetjesh në dy varreza të ndryshme në Prishtinë dhe tre grupe mbetjesh të gjetura në një fushë në komunën e Mitrovicës Veriore. Përveç kësaj, Ekipi i mjekësisë ligjore i Misionit ka ndihmuar Policinë e Kosovës në kërkimin e një varri të mundshëm të fshehur, në lidhje me zhdukjen e fundit të një personi në komunën e Vushtrrisë. Përveç kësaj mbështetjeje, Misioni vazhdoi të ndihmojë Institutin e Mjekësisë Ligjore në ekzaminimin e mbetjeve të zhvarrosura së fundmi, si dhe në shqyrtimin e mbetjeve të ruajtura në morgun e Institutit. Ekzaminimet e kryera gjatë periudhës raportuese rezultuan në mbledhjen e 34 mostrave të cilat u dorëzuan për analizë të ADN-së dhe dorëzimin e 37 kërkesave të supozuara për identifikim në laboratorin e ADN-së të Komisionit ndërkombëtar për personat e zhdukur. Në maj, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka marrë raportet e ADN-së për katër identifikime të reja dhe një raport shtesë është marrë në gusht. Së fundi, ekspertët e Mjekësisë Ligjore të Misionit kanë ndihmuar Institutin e Mjekësisë Ligjore në shqyrtimin dhe përgatitjen e rasteve të identifikuara për dorëzim tek familjet e tyre. Nga katër personat, eshtrat e të cilëve u dorëzuan, dy ishin në listën e personave të zhdukur.

Shtojca II **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Gjatë periudhës raportuese, Dritan Goxhaj u arrestua në bazë të një urdhërarresti të dhomave të Specializuara më 31 korrik 2023 nga autoritetet shqiptare në Tiranë, pas një kërkesë për bashkëpunim dhe ndihmë nga Dhomat e Specializuara drejtuar autoriteteve shqiptare. Urdhërarresti është lëshuar nga një gjyqtar i Dhomave të Specializuara në lidhje me veprat kundër administrimit të drejtësisë që përfshijnë kanosje dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. z. Goxhaj është ndaluar në Shqipëri, në pritje të vendimit të autoriteteve shqiptare për transferimin e tij në objektet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Emërimi i prokurores së re të specializuar, Kimberly West, u njoftua më 2 qershor 2023. Zonja West, e cila pason Jack Smith, pritet të marrë detyrat e saj në shtator të vitit 2023.

Dhomat e Specializuara arritën një tjetër sukses në fillim të prillit 2023, kur fjalët hyrëse të ushtruesit të detyrës së prokurorit të specializuar, avokatit mbrojtës dhe mbrojtësit të viktimave u dorëzuan nga 3 deri më 5 prill në rastin e Prokurorit të Specializuar kundër Thaçit dhe të tjerët. Dëshmitari i parë i akuzës dëshmoi në gjykatë më 11 prill 2023. Që atëherë, në gjykatë kanë dëshmuar 23 dëshmitarë të prokurorisë.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi akuzohen për gjashtë pika të akuzës për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgim, vepra të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje dhe zhdukje me forcë të personave – dhe katër akuza për krime lufte – arrestim të paligjshëm ose arbitrar dhe ndalim, trajtim mizor, torturë dhe vrasje. Rasti i dytë aktualisht në procedurë gjyqësore para Dhomave të Specializuara është rasti i *Prokurorit të Specializuar kundër Pjetër Shalës*. z. Shala akuzohet për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje si krime lufte që dyshohet se janë kryer në fabrikën e metalit në Kukës në Shqipëri. Procedura gjyqësore filloi më 21 dhe 22 shkurt 2023 me fjalët hyrëse të ushtruesit të detyrës së Prokurorit të Specializuar, avokatit mbrojtës dhe mbrojtësit të viktimave. Dëshmitari i parë i prokurorisë dëshmoi më 27 mars 2023.

Prokuroria e Specializuar përfundoi paraqitjen e provave dhe e pushoi çështjen më 6 korrik 2023, pasi thirri 10 dëshmitarë. Rasti i mbrojtjes është caktuar të fillojë më 18 shtator 2023, në pritje të rezultatit të mocionit për të hedhur poshtë disa akuza kundër të akuzuarve të ngritura nga mbrojtja.

Më 10 korrik 2023, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese u caktua të vendosë për një kërkesë të z. Shalës lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij themelore.

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës është aktualisht para Kolegjit të Gjykatës së Apelit pas parashtrimit të ankesës më 24 prill 2023 nga z. Mustafa kundër aktgjykimit të trupit gjykues I të marrë më 15 dhjetor 2022. Trupi gjykues I e gjeti z. Mustafën fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes dhe e dënoi me 26 vjet burg. Trupi gjykues e liroi z. Mustafën nga trajtimi mizor si krim lufte.

Më 6 prill 2023, Trupi gjykues I lëshoi urdhër dëmshpërblimi për të njëjtin rast, duke e urdhëruar z. Mustafën të paguaj 207.000 euro si kompensim për dëmin e shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat ai u shpall fajtor. Ekzekutimi i urdhrit për dëmshpërblim do të varet nga rezultati i aktgjykimit përfundimtar kundër z. Mustafës.

Në periudhën gjashtëmujore janë shqyrtuar 1.116 dosje dhe 629 urdhra e vendime, 372 dokumente me gjithsej 5.576 faqe të përkthyer dhe 4.207 pika të zbuluara ndërmjet palëve. Gjithsej u zhvilluan 76 seanca dhe u transmetuan në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara në tre gjuhët zyrtare të gjykatës – shqip, serbisht dhe anglisht. Regjistrimet e tij janë të disponueshme në kanalin e Dhomave të Specializuara në YouTube. Gjithsej 35 dëshmitarë dhanë dëshmitë e tyre pranë Dhomave të Specializuara gjatë periudhës raportuese.

Janë 157 viktima pjesëmarrëse në tri nga katër rastet që janë pranë Dhomave të Specializuara: 8 në rastin kundër z. Mustafës, 8 në rastin kundër z. Shalës dhe 141 në rastin kundër z. Thaçit dhe të tjerët. Procesi i aplikimit në rastin *Thaçi e të tjerët* mbetet i hapur.

Gjatë periudhës raportuese, Dhomat e Specializuara kanë kryer tri vizita të shoqëruara me të paraburgosurit për arsye humanitare në mars, maj dhe shtator 2023, në përputhje me vendimet e panelit kompetent. Këto ishin vizita njëditore gjatë të cilave të arrestuarit qëndruan në paraburgimin e Dhomave të Specializuara.

Aktualisht janë 237 individë në listën e disponueshme publike të avokatëve të kualifikuar për të punuar pranë Dhomave të Specializuara. Nga këta individë, 114 janë të kualifikuar për të përfaqësuar viktimat. Ekipet e mbrojtjes përbëhen nga 124 persona, prej të cilëve 84 janë duke punuar në rastin *Thaçi dhe të tjerët*.

Më 24 mars 2023, gjyqtarët e Dhomave të Specializuara përfunduan në ambientet e tyre seancën e tetë plenare. Gjatë seancës plenare, gjyqtarët, ndër të tjera, miratuan një ndryshim në Kodin e etikës gjyqësore për gjyqtarët e emëruar në listën e gjyqtarëve ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës (Kodi i etikës gjyqësore). Amandamenti për afron Kodin e etikës gjyqësore me politikën e Dhomave të Specializuara kundër ngacmimit, e cila u miratua në dhjetor të vitit 2022.

Rrjeti informativ i gjykatave të Dhomave të Specializuara, një forum i organizatave të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia, vizitoi Hagën nga 3 deri më 6 prill 2023, për të ndjekur fjalët hyrëse në rastin *Thaçi dhe të tjerët* dhe për të mbajtur një punëtori njëditore që përfshinte takime me kryesuesit e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Trajnimi për gazetarë është ofruar gjatë periudhës së raportimit nga Dhomat e Specializuara. Kjo përfshinte dy kurse trajnimi bazë të zhvilluara nga zëdhënësit e Dhomave të Specializuara më 15 dhe 23 mars në Prishtinë, si dhe një kurs trajnimi dyditor të organizuar më 2 dhe 3 maj 2023 në Hagë për 20 gazetarë nga Kosova. Ky i fundit u fokusua në raportimin neutral dhe objektiv të gjykimit dhe u prezentua nga dy gazetarë ndërkombëtarë me përvojë të gjerë në raportimin e procedurave pranë Dhomave të Specializuara, Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Në korrik 2023, u publikua një thirrje për emërimin e gjyqtarëve në një listë rezervë për listën e gjyqtarëve ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara, për të garantuar vazhdimin e funksionimit efikas të Dhomave të Specializuara. Çdo emërim në listë do të zbatohet vetëm kur numri i gjyqtarëve nga lista duket i pamjaftueshëm. Kjo procedurë siguron një zëvendësim të menjëhershëm të gjyqtarëve në rast të dorëheqjeve të ardhshme, pa iu drejtuar një procesi të ri përzgjedhjeje.

Në javën e datës 17 korrik 2023, presidenti dhe sekretari i Dhomave të Specializuara patën disa takime dypalëshe me disa shtete dhe përfaqësues të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, për të dhënë informacion në lidhje me mandatin e Dhomave të Specializuara, arritjet dhe sfidat me të cilat përballlet Gjykata.

Zyra e Prokurorit të Specializuar vazhdoi të intervistonte dëshmitarët dhe të dyshuarit, të shqyrtonte provat dokumentare të mbledhura gjatë hetimit të saj dhe të punonte me autoritetet përkatëse për të siguruar që dokumentet të spastrohen për përdorim në gjykatë dhe që dëshmitarët të autorizohen për të dëshmuar në gjykatë. Zyra e Prokurorit të Specializuar vazhdon të kërkojë angazhimin dhe mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar, organizatave ndërkombëtare dhe shteteve individuale në këto dhe të gjitha aktivitetet.

Shtojca III Përbërja dhe fuqia e komponentës së policisë të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më 11 shtator 2023)

<i>Shteti</i>	<i>Gra</i>	<i>Burra</i>	<i>Gjithsej</i>
Austria	1	—	1
Kanada	—	1	1
Finlanda	—	1	1
Gjermania	1	1	2
Jordania	—	1	1
Nepali	—	1	1
Sllovenia	—	1	1
Gjithsej	2	6	8

**Përbërja dhe fuqia e komponentës ndërlidhëse ushtarake e
Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në
Kosovë (nga 11 shtatori 2023)**

<i>Shteti</i>	<i>Gra</i>	<i>Burra</i>	<i>Gjithsej</i>
Austria	—	1	1
Çekia	—	1	1
Hungaria	1	—	1
Polonia	1	1	2
Republika e Moldavisë	—	1	1
Rumania	—	1	1
Sllovenia	—	1	1
Turqia	1	—	1
Gjithsej	3	6	9

Shtojca IV Harta

